



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Primiheho Me Dana 21-11-2024			
Nr. i Organi Org. Broj	Numri i Broj	Shtetësi Etniciteti	Vlera Vrednost
02	035	02	1323



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040,(Gazeta zyrtare nr 28/2008), nenin 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizata Buxhetore, dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datë 20.11.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIMIN E INVERTARIT NË OBJEKTET E ADMINISTRATËS KOMUNALE

I. Me këtë vendim Kryetari i Komunës së Vitisë formon komisionin për regjistrimin e Invertarit të pasurisë jo financiare në objektet e Administratës Komunale.

Komisioni përbëhet prej 3 antarëve dhe ka këtë përbërje:

1. Përparim Sadiku - Kryetar i Komisionit,
2. Beqir Alidema - Anëtar i Komisionit,
3. Enes Pira – Anëtar i Komisionit,

II. Detyrat dhe Përgjegjësit e Komisionit:

Komisioni në pajtim me Rregulloren e MF. nr 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare, Organizata Buxhetore ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

1. Inventarizimi i të gjithë pasurisë jofinanciare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore.
2. Verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare,
3. Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.
4. Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur;
5. Identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit,
6. Hartimin e raportit për regjistrimin e invertarit.

III. Ky Komision është organ i përkohshëm dhe mandati i tij përfundon me kryerjen e inventarizimit vjetor për vitin 2024.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i komisionit dhe Kryetari i Komunës së Vitisë.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Drejtorisë së Financave,,,
4. Arkivit,

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

